LIGJ
Nr. 5/2023

PËR MIRATIMIN E REZOLUTAVE NR. 271 "RRITJA SELEKTIVE E KAPITALIT SCI" DHE NR. 272 "RRITJA E PËRGJITHSHME E KAPITALIT GCI" TË VITIT 2018 TË KËSHILLIT TË GUVERNATORËVE TË KORPORATËS NDËRKOMBËTARE FINANCIARE (IFC)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohen rezolutat nr. 271 "Rritja selektive e kapitalit SCI" dhe nr. 272 "Rritja e përgjithshme e kapitalit GCI" të vitit 2018 të Këshillit të Guvernatorëve të Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC).

Neni 2

Këshilli i Ministrave përcakton me vendim rregullat dhe autoritetin kompetent për realizimin e rritjes së përgjithshme të kapitalit të Republikës së Shqipërisë në Korporatën Ndërkombëtare Financiare (IFC).

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 26.1.2023.

Shpallur me dekretin nr. 24 datë 15.2.2023, të presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

Njoftim Publik i Autorizuar

KORPORATA FINANCIARE NDËRKOMBËTARE

BORDI I GUVERNATORËVE

REZOLUTA NR. 271
RRITJA SELEKTIVE E KAPITALIT E VITIT 2018

Duke pasur parasysh se me rezolutën nr. 256, të miratuar më datë 9 mars 2012, Bordi i Guvernatorëve vendosi që aksionet e zotëruara të KFN-së do të rishikohen çdo pesë vjet, duke filluar në vitin 2015 dhe, si rrjedhojë, rishikimi i ardhshëm i rregullt i aksioneve të zotëruara do të fillojë në vitin 2020;

Duke pasur parasysh se në lidhje me rishikimin e aksioneve të zotëruara të vitit 2015, drejtorët e Korporatës kanë arritur në përfundimin se një rritje në kapitalin e autorizuar të KFN-së dhe alokimin selektiv të aksioneve për anëtarët, siç përcaktohet në paragrafin 3 të kësaj rezolute, do të ishte e

dëshirueshme dhe në raportin e tyre të datës 4 qershor 2018 kanë paraqitur te Bordi i Guvernatorëve një propozim për rritje të tillë;

Duke pasur parasysh se për të arritur qëllimin e rritjeve të veçanta në regjistrimin/nënshkrimin e anëtarëve, drejtorët e korporatës kanë vënë re se është e nevojshme që të gjithë anëtarët të heqin dorë nga të drejtat e tyre sipas nenit II, seksioni 2 (d) i aktit themelues të korporatës për t'u regjistruar në një pjesë proporcionale të rritjes së fondit të kapitalit të autorizuar sipas kësaj rezolute;

Tashmë, si rrjedhojë, Bordi i Guvernatorëve me anë të kësaj rezolute vendos si më poshtë:


1. Fondi i kapitalit të autorizuar të korporatës do të rritet me 919,998 aksione të fondit të kapitalit, ku secili ka një vlerë nominale prej një mijë dollarësh të Shteteve të Bashkuara (1,000 $).

2. Në mungesë të njoftimit të marrë nga korporata nga ndonjë anëtar brenda njëzet e një (21) ditëve nga data e transmetimit të kësaj rezolute te Guvernatorët për votim se ai synon të ushtrojë të drejtat e tij sipas nenit II, seksioni 2 (d) të aktit themelues për të nënshkruar pjesën e tij proporcionale të rritjes së fondit të kapitalit të autorizuar të parashikuar sipas kësaj rezolute, një anëtar i tillë do të konsiderohet se ka hequr dorë nga një e drejtë e tillë.

3. Çdo anëtar i KFN-së është i autorizuar të regjistrojë deri në numrin total të aksioneve të vendosur përbri emrit të tij në tabelën e mëposhtme, në bazë të kushteve të përcaktuara në paragrafin 5:

ANËTARI	NUMRI I AKSIONEVE TË ALOKUARA SIPAS SCI-së
AFGANISTAN	499
SHQIPËRI	1,172
ALGJERI	11,573
ANGOLA	3,660
ANTIGUA AND BARBUDA	650
ARMENI	1,625
AZERBAIXHAN	2,340
BAHAMAS	1,339
BARBADOS	936
BELIZE	578
BENIN	1,244
BUTAN	671
BOLIVI	2,532
BOSNJË DHE HERCEGOVINË	816
BOTSVANA	769
BRAZIL	52,818
BULGARIA	6,523
BURKINA FASO	1,244
BURUNDI	1,030
KEPI I GJELBËR	720
KAMBOXHIA	487
KAMERUN	2,174
REPUBLIKA E AFRIKËS QENDRORE	962
KINË	105,218
KOMOROS	364
REPUBLIKA DEMOKRATIKE E KONGOS	3,372
REPUBLIKA E KONGOS	1,037
KOSTA RIKA	1,109
BREGU I FILDISHTË	3,460
KROACI	2,868
REPUBLIKA ÇEKE	7,890
DANIMARKË	17,566
XHIBUT	791
DOMENIKA	631
REPUBLIKA DOMENIKANE	2,617
EKUADOR	3,779
EL SALVADOR	326
GUINEA EKUATORIALE	706
ETIOPI	1,451
FIXHI	1,235
GAMBIA	767
GJEORGJI	2,246
GRENADA	664
GUATEMALË	1,975
GUINEA	1,840
GUINEA-BISAO	605
GUAJANA	1,506
HAITI	1,530
HONDURAS	633
HUNGARI	10,654

ANËTARI	NUMRI I AKSIONEVE TË ALOKUARA SIPAS SCI-së
ISLANDË	1,720
REPUBLIKA ISLAMIKE E IRANIT	34,512
IRAK	3,825
IRLANDË	7,686
IZRAEL	5,941
JAPONI	163,308
JORDANI	1,983
KAZAKISTAN	4,514
KIRIBATI	671
REPUBLIKA E KORESË	37,040
KUVAIT	19,181
REPUBLIKA POPULLORE DEMOKRATIKE E LAOSIT	268
LIBAN	1,048
LEZOTO	933
LIBERI	598
LIBI	9,807
LUKSEMBURG	2,259
ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË	534
MADAGASKAR	2,030
MALDIVE	463
MALI	1,648
MAURITANI	1,291
MAURITIUS	1,554
MEKSIKË	39,601
MOLDAVI	1,958
MONGOLI	671
MOZAMBIK	1,315
MIANMAR	3,420
NAMIBI	1,905
NEPAL	1,387
ZELANDË E RE	9,635
NIKARAGUA	862
NIGER	1,217
OMAN	1,952
PAPUA GUINEA E RE	1,840
PARAGUAI	1,743
PERU	7,592
POLONI	16,908
PORTUGALI	7,414
RUMANI	6,777
RUANDA	1,483
SAMOA	767
SAO TOME DHE PRINCIPE	696
ARABIA SAUDITE	65,646
SENEGAL	2,904
SERBI	3,559
SEJSHELLET	260
SIERRA LEONE	1,030
SINGAPOR	5,497
REPUBLIKA SLLOVAKE	4,022



ANËTARI	NUMRI I AKSIONEVE TË ALOKUARA SIPAS SCI-së
SLLOVENI	1,687
ISHUJT SOLOMON	720
SOMALI	624
AFRIKA E JUGUT	17,001
SPANJË	43,509
SHËN LUCIA	990
SUDAN	1,550
REPUBLIKA ARABE SIRIANE	2,420
TAXHIKISTAN	1,188
TANZANI	1,278
TAILANDË	10,065
TIMORI LESTË	743
TOGO	1,577
TONGA	598
TURQI	25,312

ANËTARI	NUMRI I AKSIONEVE TË ALOKUARA SIPAS SCI-së
UGANDA	918
UKRAINË	13,730
EMIRATET E BASHKUARA ARABE	6,275
URUGUAI	3,517
UZBEKISTAN	3,431
VANUATU	755
VIETNAM	4,119
REPUBLIKA E JEMENIT	2,193
ZAMBIA	3,828
ZIMBABVE	3,939
NUMRI TOTAL I AKSIONEVE TË ALOKUARA	919,998

4. Kjo Rezolutë do të hyjë në fuqi kur:

(a) Rezoluta e propozuar me titull "Konvertimi i Fitimeve të Mbajtura dhe Rritja e Përgjithshme e Kapitalit e Vitit 2018" të ketë hyrë në fuqi;

(b) Guvernatorët që ushtrojnë jo më pak se katër të pestat e shumicës së fuqisë totale të votimit, kanë votuar në favor të kësaj Rezolute; dhe

(c) të gjithë anëtarët do të kenë hequr dorë nga të drejtat e tyre për të nënshkruar pjesën e tyre proporcionale të rritjes së fondit të kapitalit të Korporatës, të autorizuar sipas kësaj Rezolute.

5. Alokimi i Aksioneve dhe Termat dhe Kushtet e Nënshkrimit dhe Pagesës.
Çdo nënshkrim i autorizuar sipas paragrafit 1 më sipër do të jetë në afatet dhe kushtet e mëposhtme:

(a) Çmimi i regjistrimit/nënshkrimit do të jetë nominal;

(b) Çdo regjistrim/nënshkrim do të kryhet nga anëtari nënshkrues që depoziton pranë Korporatës jo më vonë se përvjetori i tretë i datës së hyrjes në fuqi të rritjes së fondit të kapitalit të autorizuar të Korporatës, në një formë të pranueshme për Korporatën, një Instrument Parapagimi nëpërmjet të cilit anëtari:
(i) nënshkruan numrin total të aksioneve të specifikuara në këtë Instrument;
(ii) do të paguajë për numrin total të aksioneve në një mënyrë të pajtueshme me kushtet e kësaj Rezolute;
(iii) i paraqet Korporatës se ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar një regjistrim/nënshkrim të tillë; dhe
(iv) merr përsipër t'i sigurojë Korporatës informacione të tilla për çështjet e mësipërme siç mund të kërkojë Korporata.

(c) Çmimi i regjistrimit/nënshkrimit për aksion është 1,000 $ në lidhje me dollarët amerikanë ose valutë ose valuta të tjera lirisht të konvertueshme; me kusht që nëse pagesa bëhet në valutë të tillë ose në valuta të ndryshme nga dollarët amerikan, Korporata do të bëjë

4. Kjo rezolutë do të hyjë në fuqi, kur:

a) rezoluta e propozuar me titull "Konvertimi i fitimeve të mbajtura dhe rritja e përgjithshme e kapitalit e vitit 2018" të ketë hyrë në fuqi;

b) guvernatorët që ushtrojnë jo më pak se katër të pestat e shumicës së fuqisë totale të votimit, kanë votuar në favor të kësaj rezolute; dhe

c) të gjithë anëtarët do të kenë hequr dorë nga të drejtat e tyre për të nënshkruar pjesën e tyre proporcionale të rritjes së fondit të kapitalit të korporatës, të autorizuar sipas kësaj rezolute.

5. Alokimi i aksioneve dhe termat dhe kushtet e nënshkrimit dhe pagesës.

Çdo nënshkrim i autorizuar sipas paragrafit 1 më sipër do të jetë në afatet dhe kushtet e mëposhtme:

a) çmimi i regjistrimit/nënshkrimit do të jetë nominal;

b) çdo regjistrim/nënshkrim do të kryhet nga anëtari nënshkrues që depoziton pranë korporatës jo më vonë se përvjetori i tretë i datës së hyrjes në fuqi të rritjes së fondit të kapitalit të autorizuar të korporatës, në një formë të pranueshme për Korporatën, një instrument parapagimi nëpërmjet të cilit anëtari:

i. nënshkruan numrin total të aksioneve të specifikuara në këtë instrument;

ii. do të paguajë për numrin total të aksioneve në një mënyrë të pajtueshme me kushtet e kësaj rezolute;

iii. i paraqet korporatës se ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar një regjistrim/nënshkrim të tillë; dhe

iv. merr përsipër t'i sigurojë korporatës informacione të tilla për çështjet e mësipërme siç mund të kërkojë korporata.

c) çmimi i regjistrimit/nënshkrimit për aksion është 1,000 $ në lidhje me dollarët amerikanë ose valutë ose valuta të tjera lirisht të konvertueshme; me kusht që nëse pagesa bëhet në valutë të tillë ose në valuta të ndryshme nga dollarët amerikan, korporata do të bëjë përpjekjet e saj më të mira për të bërë që valuta ose valutat e tilla të konvertohen menjëherë në dollarë amerikan dhe kjo do të përbëjë pagesën e ose ndaj, të çmimit të regjistrimit/nënshkrimit vetëm në masën që korporata do të ketë marrë pagesën efektive të dollarëve amerikan;

d) pagesa e çmimit të regjistrimit/nënshkrimit për aksionet e nënshkruara do të kryhet për të gjitha aksionet e tilla në çdo kohë ose për disa aksione të tilla herë pas here, para përvjetorit të tretë të datës së hyrjes në fuqi të rritjes së fondit të kapitalit të autorizuar të korporatës;

e) pagesa e çmimit të regjistrimit/nënshkrimit do të kryhet ose me para të gatshme ose me anë të notave premtuese pa interes sipas kërkesës, të shprehura në dollarë amerikan dhe ndryshe në një formë të pranueshme për korporatën. Ato nota premtuese do të paraqiten menjëherë për t'u arkëtuar nga korporata;

f) aksionet e fondit të kapitalit i emetohen një anëtari nënshkrues, i cili ka depozituar një instrument regjistrimi/nënshkrimii në përputhje me paragrafin 5 (b) më sipër, vetëm kur kryhet pagesa e plotë e parave të gatshme ose, sipas rastit, dorëzohen notat premtuese për ato aksione në çdo kohë ose herë pas here, dhe një anëtar i tillë do të mbajë ato aksione pas një emetimi të tillë; megjithatë, me kusht që të gjitha të drejtat, përfshirë të drejtat votuese, të fituara në lidhje me aksionet e emetuara kundrejt një

note premtuese për të cilën pagesa e plotë nuk është kryer brenda një periudhe prej njëzet ditësh nga paraqitja e saj për arkëtimin, të pezullohen derisa të kryhet pagesa e plotë;

g) në masën që ndonjë aksion i fondit të kapitalit, i cili është nënshkruar në përputhje me këtë Rezolutë, nuk do të jetë paguar në mënyrë efektive plotësisht në dollarë amerikan në ose para datës së fundit të përcaktuar për pagesë për aksione të tilla në përputhje me këtë rezolutë, këto aksione do të bëhen pjesë e fondit të kapitalit të paalokuar të KFN-së;

h) të gjitha aksionet e fondit të kapitalit që mbeten të paregjistruara ose të papaguara pas datave të përcaktuara në këtë rezolutë, do të mbeten të autorizuar dhe të paemetuar, të emetueshme nga korporata në përputhje me aktin e saj themelues.

(Miratuar më datë 16 prill 2020)

Njoftim Publik i Autorizuar

KORPORATA FINANCIARE NDËRKOMBËTARE

BORDI I GUVERNATORËVE

REZOLUTA NR. 272
RRITJA E PËRGJITHSHME E KAPITALIT E VITIT 2018

Duke pasur parasysh se drejtorët e korporatës, pas shqyrtimit të çështjes së zgjerimit të burimeve të korporatës nëpërmjet rritjes së kapitalit të saj të autorizuar, kanë arritur në përfundimin se një rritje e tillë do të ishte e dëshirueshme dhe, në raportin e tyre të datës 4 qershor 2018, i kanë paraqitur Bordit të Guvernatorëve propozim për një rritje të tillë;

Duke pasur parasysh se drejtorët e korporatës kanë propozuar që secili anëtar të autorizohet, në bazë të kushteve të caktuara, që të nënshkruajë aksionet e kapitalit të ri të sapoautorizuar në raport me numrin total të aksioneve që anëtari ka nënshkruar dhe është i autorizuar të nënshkruajë, duke përfshirë aksionet që do të emetohen në vijim të rezolutës së propozuar me titull "Konvertimi i fitimeve të mbajtura dhe rritja e përgjithshme e kapitalit e vitit 2018" dhe aksione që anëtarë të caktuar janë të autorizuar të nënshkruajnë në përputhje me rezolutën e propozuar me titull "Rritja selektive e kapitalit e vitit 2018" (në vijim e referuar si "Rezoluta e rritjes selektive të kapitalit");

Duke pasur parasysh se aksioneri më i madh i korporatës ka informuar se nuk do të ushtrojë të drejtat e tij sipas nenit II, seksioni 2 (d) të neneve për të regjistruar pjesën e tij proporcionale të rritjes së fondit të kapitalit të autorizuar të parashikuar sipas kësaj rezolute;

Duke pasur parasysh se synimi i anëtarëve është që kjo rezolutë me titull "Rritja e përgjithshme e kapitalit e vitit 2018" dhe rezoluta e propozuar me titull "Ndryshimi në aktin themelues të korporatës", të miratohet në të njëjtën kohë, duke arritur në këtë mënyrë lidhjen e synuar midis të dyjave.

Tashmë, si rrjedhojë, Bordi i Guvernatorëve me anë të kësaj rezolute vendos si më poshtë:

1. Fondi i kapitalit të autorizuar të korporatës do të rritet me 4,579,995 aksione të fondit të kapitalit, ku secili ka një vlerë nominale prej një mijë dollarësh të Shteteve të Bashkuara (1,000 $).

2. Çdo anëtar i korporatës është i autorizuar të regjistrojë deri në numrin total të aksioneve të vendosura përbri emrit të tij në tabelën e mëposhtme, në bazë të kushteve të përcaktuara në paragrafin 4:

=

ANËTARI	NUMRI I AKSIONEVE TË ALOKUARA SIPAS GCI-së
AFGANISTAN	382
SHQIPËRI	3,149
ALGJERI	15,794
ANGOLA	4,242
ANTIGUA DHE BARBUDA	212
ARGJENTINË	91,720
ARMENI	2,607
AUSTRALI	102,370
AUSTRI	42,699
AZERBAIXHAN	5,783
BAHAMAS,	1,104
BAHREIN	3,777
BANGLADESH	20,834
BARBADOS	1,046
BJELLORUSI	11,392
BELGJIKË	109,467
BELIZ	382
BENIN	610
BUTAN	1,748
BOLIVI	4,832
BOSNJË - HERCEGOVINË	1,572
BOTSVANA	463
BRAZIL	135,211
BULLGARI	12,523
BURKINA FASO	2,161
BURUNDI	508
KEPI I GJELBËR	237
KAMBOXHIA	871
KAMERUN	2,531
KANADA	175,938
REPUBLIKA E AFRIKËS QENDRORE	530
ÇAD	2,950
KILI	27,355
KINË	163,423
KOLUMBI	29,542
KOMOROS	134
REPUBLIKA DEMOKRATIKE E KONGOS	5,626
REPUBLIKA E KONGOS	578
KOSTA RIKA	2,374
BREGU I FILDISHTË	8,647
KROACI	7,047
QIPRO	4,627
REPUBLIKA ÇEKE	21,517
DANIMARKË	45,115
XHIBUT	270
DOMENIKA	270
REPUBLIKA DOMENIKANE	3,310
EKUADOR	5,746
REPUBLIKA ARABE E EGJIPTIT	28,940
EL SALVADOR	155

ANËTARI	NUMRI I AKSIONEVE TË ALOKUARA SIPAS GCI-së
GUINEA EKUATORIALE	293
ERITREA	2,022
ESTONI	3,102
ETIOPI	686
FIXHI	971
FINLANDË	33,952
FRANCË	261,749
GABON	2,743
GAMBIA	421
GJEORGJI	3,622
GJERMANI	278,821
GANË	11,996
GREQI	14,920
GRENADA	348
GUATEMALA	2,905
GUINEA	1,255
GUINEA-BISAO	210
GUAJANA	3,438
HAITI	2,212
HONDURAS	1,250
HUNGARI	28,482
ISLANDË	579
INDI	222,669
INDONEZI	68,353
REPUBLIKA ISLAMIKE E IRANIT	12,914
IRAK	1,403
IRLANDË	4,971
IZRAEL	6,303
ITALI	175,938
XHAMAIKË	9,262
JAPONI	397,880
JORDANI	2,598
KAZAKISTAN	11,310
KENIA	8,740
KIRIBAT	216
REPUBLIKA E KORESË	71,390
KOSOVË	3,145
KUVAJT	38,043
REPUBLIKA E KIRGISTANIT	3,720
REPUBLIKA POPULLORE DEMOKRATIKE E LAOSIT	677
LETONI	4,650
LIBAN	589
LEZOTO	418
LIBERI	349
LIBI	2,901
LITUANI	5,063
LUKSEMBURG	5,267
ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË	1,311
MADAGASKAR	1,510
MALAVI	3,941

ANËTARI	NUMRI I AKSIONEVE TË ALOKUARA SIPAS GCI-së
MALAJZI	35,918
MALDIVE	166
MALI	1,443
MALTË	3,493
ISHUJT MARSHALL	1,434
MAURITANI	829
MAURITIUS	4,042
MEKSIKË	77,273
SHTETET E FEDERUARA TE MIKRONEZISË	1,609
MOLDAVI	3,134
MONGOLI	502
MALI I ZI	2,239
MAROK	20,840
MOZAMBIK	1,069
MIANMAR	2,411
NAMIBI	1,414
NEPAL	2,171
HOLLANDË	121,408
ZELANDË E RE	10,483
NIKARAGUA	1,791
NIGER	663
NIGERI	59,853
NORVEGJI	38,066
OMAN	3,121
PAKISTAN	46,054
PALAU	54
PANAMA	2,178
PAPUA GUINEA E RE	3,003
PARAGUAJ	1,437
PERU	20,264
FILIPINE	29,542
POLONI	21,246
PORTUGALI	20,108
KATAR	3,569
RUMANI	11,176
FEDERATA RUSE	222,465
RUANDA	1,083
SAMOA	293
SAO TOME DHE PRINCIPE	1,147
ARABIA SAUDITE	129,015
SENEGAL	5,796
SERBI	4,909
SEJSHELLET	132
SIERRA LEONE	774
SINGAPOR	1,942

ANËTARI	NUMRI I AKSIONEVE TË ALOKUARA SIPAS GCI
REPUBLIKA SLLOVAKE	10,781
SLLOVENI	3,907
ISHUJT SOLOMON	284
SOMALI	357
AFRIKA E JUGUT	42,667
SUDANI I JUGUT	4,066
SPANJË	92,451
SRI LANKA	16,203
SHËN KITTS DHE NEVIS	1,380
SHËN LUÇIA	356
SUDAN	680
SURINAM	1,341
SVAZILEND	1,479
SUEDI	58,131
ZVICËR	95,306
REPUBLIKA ARABE SIRIANE	1,106
TAXHIKISTAN	2,959
TANZANI	2,532
TAJLANDË	28,592
TIMOR-LESTE	1,891
TOGO	2,195
TONGA	271
TRINIDAD DHE TOBAGO	8,894
TUNIZI	7,713
TURQI	41,435
TURKMENISTAN	1,752
UGANDA	1,850
UKRAINË	25,868
EMIRATET E BASHKUARA ARABE	10,219
MBRETËRI E BASHKUAR	261,749
URUGUAJ	8,717
UZBEKISTAN	9,350
VANUATU	333
REPUBLIKA BOLIVARIANE E VENEZUELES	59,671
VIETNAM	2,133
REPUBLIKA E JEMENIT	2,166
ZAMBIA	3,867
ZIMBABVE	7,955
AKSIONET TOTALE TË ALOKUARA	**4,579,995**

3. Kjo rezolutë do të hyjë në fuqi nga data kur korporata vërteton, nëpërmjet një komunikimi zyrtar drejtuar të gjithë anëtarëve, se:

a) rezoluta e propozuar me titull "Konvertimi i fitimeve të mbajtura dhe rritja e përgjithshme e kapitalit e vitit 2018" ka hyrë në fuqi;

b) rezoluta e propozuar me titull "Ndryshimi i aktit themelues të korporatës" ka arritur shumicën e nevojshme, veçanërisht tre të pestat e guvernatorëve që ushtrojnë tetëdhjetë e pesë për qind të fuqisë totale të votimit, për të hyrë në fuqi; dhe

c) guvernatorët që ushtrojnë jo më pak se katër të pestat e shumicës së fuqisë totale të votimit, kanë votuar në favor të kësaj rezolute.

4. Alokimi i aksioneve dhe termat dhe kushtet e nënshkrimit dhe pagesës.

Çdo nënshkrim i autorizuar sipas paragrafit 1 më sipër do të jetë në afatet dhe kushtet e mëposhtme:

a) çmimi i regjistrimit/nënshkrimit do të jetë nominal;

b) çdo regjistrim/nënshkrim do të bëhet nga anëtari nënshkrues që depoziton në korporatë jo më vonë se përvjetori i tretë i datës së hyrjes në fuqi të rritjes së fondit të kapitalit të autorizuar të korporatës, me kusht që, nëse ndonjë anëtar e kërkon këtë, Bordi i Drejtorëve mund të përcaktojë në çdo kohë që një periudhë e tillë të zgjatet deri në përvjetorin e katërt të datës së hyrjes në fuqi të rritjes së fondit të kapitalit të autorizuar të korporatës, në bazë të kushteve që mund të kërkohen nga Bordi i Drejtorëve në lidhje me një zgjatje të tillë, në një formë të pranueshme për korporatën, një instrument regjistrimi/nënshkrimi nëpërmjet të cilit anëtari:

i) nënshkruan numrin total të aksioneve të specifikuara në këtë instrument;

ii. do të paguajë për numrin total të aksioneve në një mënyrë të pajtueshme me kushtet e kësaj rezolute;

iii. i paraqet korporatës se ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar një regjistrim/nënshkrim të tillë; dhe

iv. merr përsipër t'i sigurojë korporatës informacione të tilla për çështjet e mësipërme siç mund të kërkojë korporata;

c) çmimi i regjistrimit/nënshkrimit për aksion është 1.000 $ në lidhje me dollarët amerikan ose valutë ose valuta të tjera lirisht të konvertueshme; me kusht që nëse pagesa bëhet në valutë të tillë ose në valuta të ndryshme nga dollarët amerikan, korporata do të bëjë përpjekjet e saj më të mira për të marrë masa që valuta ose valutat e tilla të konvertohen menjëherë në dollarë amerikan dhe kjo do të përbëjë pagesën e ose ndaj, të çmimit të regjistrimit/nënshkrimit vetëm në masën që korporata do të ketë marrë pagesën efektive të dollarëve amerikan;

d) pagesa e çmimit të regjistrimit/nënshkrimit për aksionet e nënshkruara do të kryhet, për të gjitha aksionet e tilla në çdo kohë ose për disa aksione të tilla herë pas here, para përvjetorit të pestë të datës së hyrjes në fuqi të rritjes së fondit të kapitalit të autorizuar të korporatës, me kusht që nëse ndonjë anëtar e kërkon këtë, Bordi i Drejtorëve, në çdo kohë, mund të përcaktojë që kjo periudhë do të zgjatet deri në përvjetorin e gjashtë të datës së hyrjes në fuqi të rritjes së fondit të kapitalit të autorizuar të korporatës, në bazë të kushteve që mund të kërkohen nga Bordi i Drejtorëve në lidhje me një zgjatje të tillë.

e) Pagesa e çmimit të regjistrimit/nënshkrimit do të kryhet ose me para të gatshme ose me anë të notave premtuese pa interes sipas kërkesës, të shprehura në dollarë amerikan dhe ndryshe në një formë të pranueshme për Korporatën. Ato nota premtuese do të paraqiten menjëherë për t'u arkëtuar nga korporata.

f) Aksionet e fondit të kapitalit i emetohen një anëtari nënshkrues, i cili ka depozituar një instrument regjistrimi/nënshkrimi në përputhje me paragrafin 5 (b) më sipër, vetëm kur kryhet pagesa e plotë e parave të gatshme ose, sipas rastit, dorëzohen notat premtuese për ato aksione në çdo kohë ose herë pas here, dhe një anëtar i tillë do të mbajë ato aksione pas një emetimi të tillë; megjithatë, me kusht që të gjitha të drejtat, përfshirë të drejtat votuese, të fituara në lidhje me aksionet e emetuara kundrejt një note premtuese për të cilën pagesa e plotë nuk është kryer brenda një periudhe prej njëzet ditësh nga paraqitja e saj për arkëtimin, të pezullohen derisa të kryhet pagesa e plotë.

g) Në rast se rezoluta e rritjes selektive të kapitalit e vitit 2018 nuk miratohet në ose para datës së miratimit të kësaj rezolute, atëherë asnjë regjistrim/nënshkrim nuk do të pranohet nga korporata jo më parë se:

i. data kur Bordi i Guvernatorëve miraton rezolutën për rritjen selektive të kapitalit të vitit 2018; dhe

ii. data kur korporata njofton secilin anëtar se periudha e votimit për rezolutën e rritjes selektive të kapitalit të vitit 2018, siç mund të zgjatet, është mbyllur. Nëse periudha e votimit për rezolutën për rritjen selektive të kapitalit të vitit 2018 mbyllet pa miratimin e rezolutës për rritjen selektive të kapitalit të vitit 2018 nga Bordi i Guvernatorëve, numri i aksioneve të autorizuara për t'u nënshkruar nga secili anëtar sipas paragrafit 2 më sipër, duhet të përshtatet në mënyrë që alokimi proporcional i aksioneve të secilit anëtar pas dhënies fuqi të rritjes së fondit të kapitalit sipas kësaj rezolute, do të jetë i barabartë me alokimin proporcional të aksioneve të anëtarit, pa i dhënë fuqi rezolutës për rritjen selektive të kapitalit të vitit 2018.

h) Në masën që ndonjë aksion i fondit të kapitalit, i cili është nënshkruar në përputhje me këtë Rezolutë, nuk do të jetë paguar në mënyrë efektive plotësisht në dollarë amerikan në ose para datës së fundit të përcaktuar për pagesë për aksione të tilla në përputhje me këtë rezolutë, këto aksione do të bëhen pjesë e fondit të kapitalit të paalokuar të KFN-së.

i) Të gjitha aksionet e fondit të kapitalit që mbeten të panënshkruara ose të papaguara pas datave të përcaktuara sipas kësaj rezolute, do të mbeten të autorizuara dhe të paemetuara, të emetueshme nga korporata në përputhje me aktin e saj themelues.

(Miratuar më datë 16 prill 2020)